



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS**



Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 622

Datë: 18.11. 2019

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së III-të (e tretë) të jashtzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve: Procesverbalit të mbledhjes së -VII-, mbledhjes së -VIII- dhe mbledhjes së -I- urgjente të Kuvendit të Komunës për vitin 2019.
2. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/237 datë:10.04.2019 për caktimin e lokacionit “Park të Memorialit të UÇK-së” në Malishevë, sipas shkresës përcjellëse të MAPL-së nr.020-396/11 datë: 10.05.2019.
3. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/230 datë:10.04.2019, për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit “Ndërtimi i shtëpisë së Komunitetit” sipas shkresës përcjellëse të MAPL-së nr.020-396/10 datë: 10.05.2019.
4. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/496 datë:02.09.2019, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së në Malishevë, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-929/1 datë: 11.09.2019.
5. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/497 datë:03.09.2019, për bartjen dhe ridestinimin e mjeteve vetanake nga viti 2017 dhe 2018 në vitin 2019, sipas shkresës së MAPL-së nr.020-938/3 datë: 03.10.2019.

Mbledhja mbahet me datë 16.10.2019 dhe filloi në ora 10:20 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 20 asambleistë, Shefi i Zyrës së Kryetarit, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, LMT dhe media.

**Rrahim Morina:** Pershendetje për të gjithë! e hapi mbledhjen e III-të të jashtëzakonshme, korrur kemi sepse janë 20 të pranishëm nga asambleistët. Materialin e keni marrë dhe në mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka diskutime jashtë rendit të ditës. Atëherë e hedhi në votim rendin e ditës. Kush është pro që të miratohet ky rend i ditës?

Për: unanimitet (22)

Rendi i ditës u aprovua me votim unanimitet.

Jemi të pika e 1-rë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve: Procesverbalit të mbledhjes së -VII-, mbledhjes së -VIII- dhe mbledhjes së -I- urgjente të Kuvendit të Komunës për vitin 2019. E hapi debatin për këtë pikë.

Nëse s'ka debatues e hedhi në votim këtë pikë. Kush është pro që të miratohen këto procesverbale?

Për: unanimitet

Kalojmë në pikën e 2-të të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/237 datë:10.04.2019 për caktimin e lokacionit "Park të Memorialit të UÇK-së" në Malishevë, sipas shkresës përcjellëse të MAPL-së nr.020-396/11 datë: 10.05.2019. problematika këtu ka qenë që në preambul të vendimit nuk janë vendosur nenet dhe ligjet që janë dashur sipas Ligjit për Planifikim Hapësirorë. Kjo çështje është përmirësuar dhe i kemi dy vendimet të cilat Drejtoria për Urbanizëm i ka sjellë me sqarime dhe të mbështetur në PZHK. Mëqë janë të përmirësuar mendoj që nuk ka nevojë për debat prandaj i kish ahedhur të dy pikat në votim edhe pikën e 2-të të rendit të ditës edhe pikën e 3-të të rendit të ditës. Atëherë kush është për?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 3

Me këtë votim aprovohet sqarimi nga Drejtoria për Urbanizëm rreth dy vendimeve të Kuvendit Komunal.

Kalojmë në pikën e 4-ër të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/496 datë:02.09.2019, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së në Malishevë, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-929/1 datë: 11.09.2019. Para se të hapi debat për këtë pikë kërkoj një sqarim nga Muharremi.

**Muharem Morina:** Kërkesa e shoqatave të dalura nga lufta është trajtuar në Kuvendin Komunal në Malishevë dhe ka marrur miratim për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit që kanë kërkuar ato shoqata. Kur është marrë vendimi prona e përcaktuar ka qenë pronë në emër të ndërmarrjes "Mirusha". Kjo ndërmarrje është nën menaxhim të AKP-së dhe është dashur që kur të merret vendimi të shkojmë me procedurën për shpalljen e zonës së interesit të përgjithshëm. Me ligjin e ri ne kemi të drejtë të shapllim interes të përgjithshëm për një pronë me marrë për interesin publik të komunës, mirëpo mbrenda 4 viteve komuna nuk ka të drejtë që këtë pronë me ja dhënë subjektit të tretë në këtë rast shoqatave, prandaj MAPL ja është kthyer me këtë shkresë. E di baci Ilaz e kemi diskutuar sepse ne i kemi ditur këto procedura por për hirë të respektit ndaj shoqatave e kemi marrë këtë vendim. MAPL –ka kërkuar me kthi mbrapa këtë vendim dhe tash

është në dorën e juaj që a doni të ndani një tjetër lokacion apo doni të merrni një vendim për shpalljen zonë e interesit të përgjithshëm atë pjesë që prona të mbetet në emër të Komunës së Malishevës edhe pse mund të ndërtohet objekti aty.

**Rrahim Morina:** E hapi debatin për këtë pikë.

**Alban Krasniqi:** Pershendetje për të gjithë! Lidhur me çështjen në fjalë duhet bërë disa sqarime. Mendoj që e para kjo zonë duhet të shpallet zonë e interesit publik dhe e dyta nëse ka nevojë proceduaralisht që të shfuqizohet vendimi që e kemi marrë e bëjmë dhe mund ta lëjmë në mbledhjen e ardhshme që ta marrim vendimin e radhës. Në vendimin e radhës të cekim që ajo mbetet tokë publike por e përcakton që toka ndahet për ndërtimin e një objekti për nevojat e shoqatave të dalura nga lufta. Pra toka i përket komunës, objektin e ndërton komuna kurse ja jap për shfrytëzim shoqatave të dalur nga lufta.

**Sylë Dukolli:** Pershendetje për të gjithë! Mendoj që kur marrim vendime të tilla duhet të jemi me të kujdesëshëm dhe të vëmendshëm sepse mos të vien nga dy herë në Kuvend. Më kujtohet fjalimi i Profesoreshës Hidajete kur ajo ka thënë që duhet të kemi kujdes për këtë pronë. Jam që zona në fjalë të shpallet për interes publik, prona t'i mbetet komunës e të ndërtohet objekti për vlerat e luftës, pra ti ndjekim të gjitha procedurat ligjore.

**Hidajete Mazreku:** Pershendetje për të gjithë! Nuk jam befasuar për këtë çështje sepse e pata thënë që nuk mund të jepet ajo pronë sepse nuk e ka nën pronësi Kuvendi Komunal. Jo që kam qenë kundër këtyre vendimeve por këto vendime nuk kanë pasur bazë juridike. Nuk kam kundër shoqiatave të dalura nga lufta po kam qenë kundër për t'i rrejtur këto shoqia të për atë kam kërkuar ndonjë lokacion tjetër e që është i përshtatshëm për to.

Kryesues, kërkoj nga ju që në të ardhmën të kemi një përfaqësues ligjor këtu, Muharrem nuk kam asgjë kundër teje, por ti je Këshillëtar i Kryetarit e ndoshta anon nga ai. Ne kemi nevojë si Kuvend që të marrim këshilla juridike që në të ardhmen mos t'i bëjmë këto gabime trashanike. Kur kam diskutuar për këtë çështje ju kam treguar që nuk keni baza ligjore por unë kam hasur në vesh të shurdhur si nga ana e Kryesuesit ashtu edhe nga ju kolegë asambleistë.

E di që zonë e interesit nuk mund të shpallet kjo pjesë sepse është pronë e ndërmarrjes "Mirusha" e që e meanxhon AKP-ja. Ne nuk kemi të drejtë as ta shpallim zonë të interesit e as t'ja japim dikujt duke aloduar që kjo pronë është private e që është marrë nga sistemi jugosllav dhe tani është në kontekst gjyqësor.

**Rrahim Morina:** Muharremi e sqaroi jo edhe ne që nuk e kemi ditur por për hir të asaj për t'ju dalur haku shoqiatave e kemi marrë këtë vendim. Asgjë nuk ka të keqe këtu, tani marrim një vendim tjetër edhe rregullohet kjo çështje.

**Ilaz Krasniqi:** Pershendetje për të gjithë! Unë do të flas në emër të Komitetit dhe të këtyre kategorive të dalura nga lufta. Ne kemi insistuar gjithëmonë që ta kemi një objekt tonin e të mos kemi inate asi komitet si si orgnazitatë dalura nga lufta. Ne i përkrahim të gjitha anët ligjore që të shkoj kjo procedurë ashtu siç duhet por nuk kemi qëllim që të mashtrojmë askënd por të kontribuojmë aty ku është e mundur. Ata kërkojnë që ta kenë adresën e tyre, të takohen e të punojnë ashtu siç ju ka hije. Organizatat e luftës asgjë nuk dojnë jashtë ligji t'ju jepet. Le të shkoj edhe kjo çështje në baza ligjore.

**Muharrem Morina:** Hidajete, sa i përket çështjes që ka kërkuar Komiteti për familje të dëshmorëve, veteranë dhe invalidë të luftës, të gjitha ato që po i thua ti ne me kohë i kemi thënë në zyre të Kryesuesit dhe Kryetarit.

Çdo vendim që merrni këtu ju ne e shikojmë me llup, por vendimet e juaja ne nuk mund t'i ndryshojmë sepse ato janë vendime politike.

Çështja a ka apo jo të drejtë, këtë e përcakton veç ligji. Kuvendi ka të drejtë me marrë secilën pronë për interes publik. Ajo pjesë a është në procedurë kontestimore, me padi, apo nuk është atë unë nuk e di. Nëse ka ka padi atëherë atë e ndal gjykata.

**Rrahim Morina:** Mbase s'ka diskutues të tjerë shkojmë në shfuqizim të vendimit. Pastaj marrim vendimin për shpalljen e zonës së interesit në atë pjesë.

**Hidajete Mazreku:** Nuk kam asgjë kundër shoqiatave të dalura nga lufta, por çështja mbase është në kontekst gjyqësor pse të marrim vendim ne?! E thash edhe me herët që ato prona kanë pronarë privat po ju ka marrë sistemi i sllav. Ne nuk mund ta shpallim zonë të interesit atë pjesë pa bërë kërkesë te AKP-ja. AKP-ja në Dhomën e Posaqme i ka ka me mijëra lëndë. Parlamendi i Kuvendit të Kosovës duhet me u marrë me ato prona, jo ne.

**Rrahim Morina:** Në konsultim me Muharremi sot duhet të ndahet lokacioni për shpalljen zonë e interesit të përgjithëshëm të mbetet për mbledhjen tjetër për shkak që kërkesa duhet të vie nga Kryetari, pra sot e bëjmë veç shfuqizimin e vendimit.

Atëherë kush është pro shfuqizimit të vendimit të Kuvendit Komunal nr.02/496 datë:02.09.2019 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së në Malishevë?

Për: unanimisht

Me votim unanim shfuqizohet vendimi në fjalë.

Kalojmë në pikën e 5-të të rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës nr.02/497 datë:03.09.2019, për bartjen dhe ridestinimin e mjeteve vetanake nga viti 2017 dhe 2018 në vitin 2019, sipas shkresës së MAPL-së nr.020-938/3 datë: 03.10.2019.

Meqë Kryetari, Nënkryetari dhe drejtori i Drejtorisë së Financave nuk është këtu, atëherë fjalën e ka Zyrtari i Kryesor i Buxhetit Halil Shurdhaj.

**Halil Shurdhaj:** Pershendetje për të gjithë! Vendim për bartjen dhe ridestinimin e mjeteve vetanake nga viti 2017 dhe 2018 në vitin 2019 nuk është procesuar në Ministrinë e Financave, gjejmësisht në Departamentin e Buxhetit për arsye kryesore sepse nuk lejohet ndryshimi i strukturës së tyre. Preveç ndryshimit të strukturës së mjeteve kemi edhe një lëshim tjetër ku granti specifik i shëndetësisë dhe granti specifik i arsimit nuk guxojnë të financojnë grantin e përgjithëshëm. Pra kjo është arsye pse ka ardhur në rishqyrtim ky vendim. Para jush e keni edhe formën tjetër për bartjen e mjeteve vetanake në mënyrë tabelare dhe kërkoj që ta votoni ashtu siç është sepse edhe ashtu jemi vonë.

**Rrahim Morina:** E hapi debatin për këtë pikë.

**Alban Krasniqi:** Po kthehem edhe njëherë tek pika e mëparshme që ata që nuk e kanë të qartë atë çështje le ta lexojnë Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Malishevës etj. Ne kemi të drejtë që çfarëdo prone qoftë edhe prone private kemi të drejtë që të ta shpallim zonë të interesit të përgjithëshëm sepse interesi publik është mbi interesin individual. Kur të flasim për këtë pikë për të hyrat vetanake ju nuk na keni dërguar shkresën për këtë çështje, pra që nuk mund ti orientojmë andej nga ka nevojë. Nëse ka nevojë ne i ndërrojmë kodet, por qëllimi i destinimit të tyre nuk duhet të ndërrohet sepse ato kanë qenë të nevojshme për aty. Le të jetë e fundit herë kjo që neve na tregojnë se nga të orientojnë të hyrat vetanake e që janë tonat e që nuk është grant i barutur prej nivelit qendror.

**Hidajete Mazreku:** Kam vërejtje për këtë fletë sepse s'kam mund ta lexoj sepse ka qenë jo në rregull dhe nuk e di çka ka kthyer MAPL-ja. Atë ditë kur është marrë ky vendim unë kam abstenuar sepse ai ridestnim më është dokur qesharak sepse të gjithë kërkonin aty e këtu. Kjo ka qenë jashtëligjore sepse këto bartje të mjeteve patjetër duhet të pranohen nga Ministria e Financave. Këto të hyra janë arketuar në vitin 2018 dhe në raport nuk u paraqiten këto të hyra, madje as në raportin 3-mujor, as atë 6-mujor. Atëherë ku kanë qenë këto të hyra?

**Sylë Dukolli:** Në mbledhjen e kaluar drejtori i Financave na ka sqaruar këtë, por disa nga ju patën thënë që le ta kthej MAPL-ja pastaj ne e rregullojmë. Mendoj që këtë punë duhet ta kryejmë sot Kryesues dhe kërkoj që ta votoni të gjithë ju. Kërkoj që herave tjera të kemi më shumë kujdes e të mos na përsëriten situata të tilla.

**Alban Mazreku:** Pershendetje për të gjithë! Ju po thoni që nga granti i arsimit mos të barten mjetet, por ne njëherë këtu e patëm marrë një vendim për pagesën e tri pagave përcjellëse dhe pagës jubilarë e që i kemi marrë nga projekti i një shkolle. Pagat nuk i kanë marrë, e mjetet nuk e dinë kah kanë shkuar.

**Halil Shurdhaj:** Ju e dini që buxheti i komunave përbëhet prej disa fondeve. Fondi kryesor është granti qeveritar, ndër të tjera janë edhe ty hyrat vetanake. Të hyrat vetanake ju i destinoni. Hidajete, çdo 3 muaj ju i shqyrtoni raportet financiare dhe aty i ke të precizuara shpenzimet nga granti qeveritar dhe nga të hyrat vetanake. Aty paraqitet edhe grumbullimi i të hyrave vetanake veç shikojneni me kujdes raportet.

**Hidajete Mazreku:** Duke u nisur nga raporti i juaj finaciari pse nuk janë vu ne pah këto? Ne jemi që të shpenzohen ato mjete por nuk janë raportuar sepse të hyrat buxhetore duhet patjetër të kanlizohen. Nuk duhet që bartja e mjeteve të vie në shtator, por më herët më kohë pasi që janë mjete të bartura.

**Rrahim Morina:** Është kërkesa e drejtorit të Financave e nënshkruar nga Kryetari me nr.04/176 e datës 09.10.2019 për bartjen e mjeteve vetanake nga viti fiskal 2017 dhe 2018 në vitin 2019.

Kush është për?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me ksaqe mbledhjen e shpalli të mbyllur, falemnderit për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në ora 11: 30.

Procesmbajtësja: Samire Krasniqi

---

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina

---